



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

Datë: 30.06.2025
Numër Protokolli: 4922/2025

A.nr.768/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës – Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi, kryetare, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Kaltrina Avdullahi-Prenaj, si procesmbajtëse, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.768/2025, të datës 30.04.2025, të parashtruar nga ankuesja M.D-K, kundër organit të punësimit: Instituti i Krimeve të Kryera Gjatë Luftës në Kosovë, në çështjen juridike “*Kontestim konkursi*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, nenin 16, paragrafi 3 si dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshilli dhe votim të datës 30.06.2025 mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.768/2025, e datës 30.04.2025, e parashtruar nga ankuesja, M.D-K.

II. Mbetet në fuqi Njoftimi i datës 23.04.2025, i Njësisë së Burimeve Njerëzore në Institutin për Krimet e Kryera Gjatë Luftës në Kosovë, lidhur më shpalljen e rezultatit përfundimtar, për procedurën e pranimit me nr.ref: RN00016671, pozita e punës Zyrtar për Rregullimin e Materialit Arkivor.

A r s y e t i m

Kandidatja për pranim në shërbim civil M.D-K, (në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesja), më datë 30.04.2025, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër vlerësimit të testit me shkrin në procedurën e rekrutimit nr.ref: RN00016671, për Grupin e Arkivit-Dokumentacionit, pozita e punës Zyrtar për Rregullimin e Materialit Arkivor, të shpallur nga Instituti i Krimeve të Kryera Gjatë Luftës në Kosovë.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 08.05.2025, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Instituti i Krimeve të Kryera Gjatë Luftës në Kosovë, ndërsa, kjo e fundit, më datë 12.05.2025, ka përcjellë përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejshëm referuar: Kolegji i Këshillit) administroi këto prova: Ankesën me numër protokollit 2856/2025, të datës 30.04.2025 të parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kopjen e dokumentit të identifikimit të ankueses; Formularin e parashtrimit të ankesës; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 08.05.2025; Përgjigjen në ankesë të datës 12.05.2025, së bashku me dokumentet e bashkangjitura; Konkursin me numër protokollit RN0016671, të datës 11.02.2025; Lista e aplikantëve; Listën e kandidatëve të aprovuar të datës 24.03.2025; Vendimin me Nr.01/5/250, të datës 01.04.2025 për themelimin e Komisionit të Pranimit; Akt emërimit me nr.08/2024 të datës 01.08.2024; Akt emërimit me nr.07/2024, të datës 01.08.2024; Akt emërimit me nr.11/2024 të datës 02.09.2024; Akt emërimit me nr.06/2025, të datës 03.03.2025; Akt emërimit me nr.02/2024 të datës 01.08.2024; Përshkrimin e detyrave të punës për pozitën e shpallur; Kërkesën për fillimin e procedurës nr.02/3/081 të datës 10.02.2025; Akt emërimit me nr.01/018 të datës 01.07.2024; Njoftimin për test me shkrim të datës 03.04.2025; Njoftimin e datës 17.04.2025; Formularin e vlerësimit individual të anëtarëve të komisionit për kandidatët në intervistë të datës 23.04.2025; Njoftimin e datës 16.04.2025; Rezultatet përfundimtare të vlerësimit nga SIMBNJ; Njoftimin për shpalljen e rezultatit përfundimtar të datës 23.04.2024; Raportin përfundimtar të procesit të rekrutimit të datës 23.04.2025; Testin me shkrim të datës 08.04.2025 për ankuesen M.D-K; Testin me shkrim të datës 08.04.2025 për kandidaten fituese S.G; Aplikacionin me datë aplikimi 12.02.2025 të kandidates M.D-K së bashku me dokumentet e bashkangjitura; Aplikacionin me datë aplikimi 18.02.2025 të kandidates S.G së bashku me dokumentet e bashkangjitura; Vendimin me numër protokollit 4014/2025 të Kryetarit të Këshillit.

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, ka gjetur se ankesa është e pabazuar, **sepse:**

Nga administrimi i shkresave të lëndës rezulton se Instituti i Krimeve të Kryera Gjatë Luftës në Kosovë, ka shpallë konkursin publik për pranim me nr.ref: RN00016671, për Grupin e Arkivit-Dokumentacionit, pozita *Zyrtar për Rregullimin e Materialit Arkivor*, në Divizionin për Përpunim dhe Arkivim, me klasë të pozitës profesional 2, një (1) vend pune, i hapur për aplikim nga data 12.02.2025 deri më 13.03.2025.

Rrjedhimisht, nga shkresat e lëndës rezulton se në këtë konkurs kanë aplikuar gjithsejtë (22) kandidatë, ndër ta edhe ankuesja, e cila e ka kaluar fazën e verifikimit paraprak duke i plotësuar kushtet e konkursit, ndërsa, e njëjta i është nënshtruar edhe fazës së testimit me shkrim dhe ka mbledhur gjithsej (48.6) pikë, si pikë të mjaftueshme për të vazhduar me fazën tjetër të vlerësimit, gjegjësisht vlerësimit të intervistës me gojë.

Njësia e Burimeve Njerëzore në Institutin e Krimeve të Kryera Gjatë Luftës në Kosovë, më datë 23.04.2025, ka publikuar Njoftimin për shpalljen e rezultatit përfundimtar, nga i cili njoftim rezulton se si kandidatë të suksesshme për procedurën përkatëse janë shpallur S.G me gjithsej (80.6) pikë dhe Sh.D-F më 77 pikë.

Pas publikimit të Njoftimin për shpalljen e rezultatit përfundimtar të datës 23.04.2025, ankuesja ka parashtruar ankesë brenda afatit ligjor në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nën supozimin se janë bërë manipulime me vlerësimin e rezultatit të testit me shkrim, në favor të kandidatit fitues. Kërkon nga Këshilli që të aprovoj ankesën si të bazuar dhe të anuloj procedurën e rekrutimit në tërësi.

Kolegji i Këshilli në përmbushje të mandatit kushtetues dhe ligjor lidhur me sigurimin e respektimit të rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil, e ndërlidhur me nenin 86 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ku përcaktohet se: "*Organi*

publik përcakton, në mënyrë të pavarur, llojin dhe shtrirjen e shqyrtimit administrativ, si dhe vlerëson nëse një fakt apo rrethanë është e nevojshme për zgjidhjen e çështjes”, ka analizuar në kuptim të ligjshmërisë veprimet administrative të ndërmarra në procedurën e pranimit me nr.ref: RN00016671 dhe si rrjedhojë Kolegji nuk ka arritur të evidentoj shkelje esenciale ligjore e të cilat si të tilla do ta cenonin vlefshmërinë ligjore të kësaj procedure. Në këtë kontekst, fillimisht, Kolegji ka analizuar aktin e shpalljes së konkursit me nr.ref: RN00016671, ku dhe vërtetoj se si kërkesa të përgjithshme formale për pozitën përkatëse janë përcaktuar: **Arsimimi i kërkuar: Diplomë e arsimit të lartë e nivelit të parë (Bachelor) në Juridik, Histori, Letërsi, Arkivistikë, Orientalistik, Antropologji, Ballkanistikë; Përvoja e punës e kërkuar: Së paku 1 (një) vite përvojë pune në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë të punës.** Kolegji vlerësoj se kriteret e përgjithshme formale për pozitën përkatëse të punës kanë qenë në pajtim me Rregulloren (QRK) Nr.06/2024 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil.

Në fakt, Kolegji lidhur me këtë çështje juridike-administrative, ju referua bazës ligjore në fuqi, gjegjësisht Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë, me theks të veçantë:

- Nenit 9 paragrafi 1, ku përcaktohet se: *1. Kriteret e përgjithshme që një person duhet t'i plotësojë në procedurën e rekrutimit, për t'u pranuar si zyrtar publik në cilëndo kategori apo nivel, janë: 1.1. të jetë shtetasi Republikës së Kosovës; 1.2. të ketë zotësi të plotë veprimi, sipas legjislacionit në fuqi; 1.3. të zotërojë të paktën njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët; 1.4. të jetë e/i aftë për të kryer detyrën përkatëse; 1.5. të mos jetë e/i dënuar për kryerjen e veprës penale me dashje; 1.6. të mos ketë në fuqi masë disiplinore për shkelje të rëndë në institucion publik; 1.7. të ketë arsimin, përvojën e punës profesionale dhe/apo aftësitë e kërkuara për pozitën, kategorinë, klasën apo grupin përkatës; dhe 1.8. të kaloj me sukses procedurat e pranimit të përcaktuara në këtë ligj”*,

-Nenit 39, ku përcaktohet se: *7. Konkurrimi zhvillohet në dy (2) faza: 7.1. verifikimi paraprak përmes të cilit verifikohet nëse kandidatët i plotësojnë kriteret e përgjithshme dhe ato të veçanta, sipas shpalljes së konkursit; dhe 7.2. vlerësimi profesional që përfshin vlerësimin e njohurive dhe cilësive profesionale të kandidatëve. 8. Verifikimi paraprak kryhet nga njësia përgjegjëse, ndërsa vlerësimi profesional i kandidatëve bëhet nga komisioni i pranimit i krijuar për secilin grup të administrimit të përgjithshëm apo administrimit të veçantë, për të cilin zhvillohet rekrutimi. 9. Vlerësimi profesional i kandidatëve përfshin testim me shkrim në formë elektronike ku sigurohet anonimiteti i konkurrentëve, si dhe intervistë me gojë. 10. Totali i pikëve të vlerësimit të kandidatëve është njëqind (100) pikë. 11. Në përfundim të vlerësimit, kandidatja/i fitues konsiderohet kandidatja/i i vlerësuar me më së shumti pikë, por jo më pak se shtatëdhjetë për qind (70 %) të pikëve totale të vlerësimit. Të gjithë kandidatet/ët njoftohen individualisht me rezultatet e procesit të rekrutimit. Lista e kandidateve/ëve që kanë kaluar pragun prej shtatëdhjetë për qind (70%) të pikëve totale publikohet në SIMBNj-së, si dhe në ueb faqen e institucionit përkatës”.*

Po ashtu, Kolegji i Këshillit për vendosje të drejtë dhe meritore lidhur me çështjen administrative në procedurë ankimore, mori parasysh edhe dispozitat e Rregullores (QRK) Nr.15/2023 për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, me konkret:

- Nenin 7: *Verifikimi paraprak 1. Verifikimi paraprak është procesi i verifikimit nëse kandidatët për pranim në shërbimin civil plotësojnë kriteret e përgjithshme dhe ato të veçanta, sipas shpalljes së konkursit. 2. Verifikimi paraprak kryhet nga NjMBNj, më së largu pesëmbëdhjetë (15) ditë pas kalimit të afatit për pranimin e aplikacioneve, në bazë të dokumenteve të paraqitura si pjesë e aplikimit. 3. NjMBNj publikon në SIMBNj dhe uebfaqen e institucionit listën e kandidatëve të cilët i plotësojnë kriteret e përgjithshme dhe ato specifike. 4. NjMBNj njofton kandidatët që nuk plotësojnë kushtet për rekrutim, duke përfshirë të gjitha kriteret dhe/ose dëshmitë e pa përmbushura jo më vonë se tre (3) ditë kalendarike nga data e publikimit të rezultateve.*

-**Nenin 8:** *Vlerësimi profesional Faza e vlerësimit profesional përbëhet nga testi me shkrim dhe intervista dhe zhvillohet nga Komisioni i Pranimit me mbështetjen e NjMBNj.*

Neni 9 Vlerësimi nëpërmjet testimit me shkrim 1. Vlerësimi nëpërmjet testimit me shkrim është hapi i parë i procesit të vlerësimit profesional të kandidatëve pas verifikimit paraprak, dhe duhet të realizohet më së largu 15 ditë pas publikimit të listës së kandidatëve që kanë kaluar verifikimin paraprak. 2. Në testimin me shkrim, kandidatët vlerësohen për njohuritë, aftësitë dhe cilësitë kryesore të domosdoshme, të kërkuara për pozitën apo grupin e pozitës përkatëse. 3. Vlerësimi maksimal i mundshëm për testimin me shkrim është deri në shtatëdhjetë (70) pikë. 4. Testimin me shkrim e kalojnë vetëm kandidatët që marrin të paktën pesëdhjetë (50) pikë në testimin me shkrim. 5. Komisioni i Pranimit në përbërje të plotë është i obliguar ditën e zhvillimit të testimit me shkrim të përzgjedhë nga bankat e pyetjeve që disponon Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë, pyetjet e testit me shkrim të modelit zgjedhje e shumëfishtë me një përgjigje të saktë, si dhe një ese me shkrim, duke marrë parasysh fushat e njohurive dhe aftësive të përcaktuara në shpalljen për rekrutim. 6. Testi me shkrim përmban gjithësej njëzet e pesë (25) pyetje dhe një (1) ese të shkurtër. Secila përgjigje e saktë vlerësohet me dy (2) pikë, ndërsa eseja mund të vlerësohet me më së shumti njëzetë (20) pikë. 7. Kohëzgjatja e testimit me shkrim është jo më shumë se nëntëdhjetë (90) minuta. 8. Anëtarët e Komisionit të Pranimit, vlerësojnë testin me shkrim në mënyrë të pavarur dhe të paanshme, më së voni në afat prej dhjetë (10) ditësh nga dita e përfundimit të tij. Pyetjet me zgjedhje të shumëfishtë vlerësohen nga sistemi në mënyrë elektronike, ndërsa eseja vlerësohet nga Komisioni i Pranimit. 9. Eseja vlerësohet nga të gjithë anëtarët e Komisionit të Pranimit në mënyrë individuale, të cilët e nënshkruajnë formularin e vlerësimit dhe vendosin pikët në SIMBNJ. Mbledhja e pikëve të secilit anëtar të Komisionit, nxjerr mesataren e vlerësimit përfundimtar për ese nga ana e Komisionit, për një kandidat të caktuar. Shuma e pikëve të vlerësuara nga sistemi dhe pikëve të esesë, përbën vlerësimin përfundimtar të testimit me shkrim. 10. Pas vlerësimit të testimit me shkrim, NjMBNj sipas rekomandimeve të Komisionit të Pranimit e përpilon listën e kandidatëve që e kanë kaluar testimin me shkrim. 11. Lista sipas paragrafit 10 të këtij neni bëhet publike nga NjMBNj në SIMBNj, faqen e institucionit si dhe me mjete të tjera të përshtatshme të informimit.

-Nenin 10: Vlerësimi nëpërmjet intervistës 1. Pas vlerësimit të testimit me shkrim, vlerësimi i kandidatëve vazhdon me intervistën, e cila realizohet në mënyrë verbale e cila duhet të përfundojë më së voni pesëmbëdhjete (15) ditë pas publikimit të listës së kandidatëve që kanë kaluar testimin me shkrim. 2. Vetëm kandidatët që kanë marrë të paktën pesëdhjetë (50) pikë në testimin me shkrim, kanë të drejtë të marrin pjesë në intervistë. 3. Komisioni i Pranimit njofton kandidatët që kanë kaluar me sukses testimin me shkrim lidhur me ditën, kohën dhe vendin e mbajtjes së intervistës. 4. Në intervistë, vlerësohen njohuritë, aftësitë dhe cilësitë e kërkuara që nuk mund të vlerësohen nëpërmjet testimit me shkrim. 5. Intervista zhvillohet nga Komisioni i Pranimit i cili përgatit apo përzgjedh nga bankat e pyetjeve grup pyetjesh të njëjta për të gjithë kandidatët për intervistën. Këto pyetje duhet të përgatiten/përzgjedhin në ditën e zhvillimit të intervistës, përveç pyetjes për prezantim nga paragrafi 7 i këtij neni që përzgjidhet dhe u dërgohet kandidatëve së bashku me njoftimin për orarin e intervistës. 6. Intervista në kategorinë profesionale, të ulët dhe të mesme drejtuese, përmban pesë (5) pyetje, ku secila vlerësohet me më së shumti katër (4) pikë. Përveç pyetjeve, anëtarët e Komisionit të Pranimit mund të parashtrojnë edhe nënpyetje për kandidatin me qëllim të vlerësimit më të saktë të kandidatit lidhur me pyetjen kryesore. 7. Intervista për kandidatët për pozitë e kategorisë së lartë drejtuese bazohet në kompetencë dhe përmban pesë (5) pyetje të cilat vlerësohen me më së shumti tre (3) pikë, si dhe një (1) pyetje për prezantim e cila vlerësohet me më së shumti 5 pikë. 8. Secili nga anëtarët e Komisionit të Pranimit bën vlerësimin e detajuar për secilën pyetje. 9. Në intervistë kandidati mund të merr më së shumti tridhjetë (30) pikë, ku prej tyre dhjetë (10) pikë janë për jetëshkrimin (CV). 10. Vlerësimi maksimal për jetëshkrimin ndahet si vijon: 10.1. deri në tre (3) pikë për arsimimin; 10.2. deri në katër (4) pikë për përvojën relevante në punë; dhe 10.3. deri në tre (3) pikë për trajnimet relevante. 11. Vlerësimi përfundimtar i intervistës për një kandidat është mesatarja aritmetike e vlerësimeve e të gjithë anëtarëve.

-Nenin 11: Shpallja e rezultatit përfundimtar 1. Vlerësimi përfundimtar i kandidatit përfshin shumën e pikëve të përfituara në secilin hap të vlerësimit. 2. Pas përfundimit të intervistës, Komisioni i Pranimit përgatit listën përfundimtare të kandidatëve që kanë kaluar pragun prej 70%

të pikëve totale që e përcjell te NjMBNj, emrin dhe mbiemri e kandidatit fitues, si dhe pikët e arritura në testin me shkrim, intervistën dhe pikët e përgjithshme për secilin kandidat.

Si rrjedhojë, bazuar në kuadrin përkatës ligjor, si dhe duke u nisur nga pretendimi ankimor i ankueses se procedura përkatëse e rekrutimit është manipuluar dhe duke qenë së ky pretendim i referohet testimi me shkrim, Kolegji nga shqyrtimi i provave të administruara ka konstatuar se vlerësimi i kandidatëve është realizuar në mënyrë elektronike, pyetjet e testit kanë qenë të njëjta për të gjithë kandidatet, dhe të përgatitura në pajtim me kërkesat ligjore të përcaktuara me nenin 9 paragrafi 5 dhe 6 të Rregullores Nr.15/2023 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, pasi që, testi ka përmbajtur 25 pyetje më përgjigje të shumëfishta dhe një pyetje në formë të eseja dhe së pyetjet i referohen njohurive lidhur me pozitën e shpallur dhe njohurive të përgjithshme. Ndërsa, nga shqyrtimi i testit të ankueses Kolegji nuk vëren shkelje në kuptim të vlerësimit të drejtë të ankueses, mbi arsyet, se ankuesja në pyetjet më përgjigje të shumëfishta ka dhënë 16 përgjigje të sakta duke arritur 32 pikë (çdo përgjigje e saktë e vlerësuar me nga dy pikë), ndërsa, lidhur me esen është vlerësuar me 16.6 pikë, nga 20 pikë maksimale, duke grumbulluar gjithsej 48.6 pikë, pikë këto të pamjaftueshme për të vazhduar me fazën tjetër të vlerësimit, sikurse parashihet me nenin 9 paragrafi 4 të Rregullores Nr.15/2023 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, ku përcaktohet se: *4. Testimin me shkrim e kalojnë vetëm kandidatët që marrin të paktën pesëdhjetë (50) pikë në testimin me shkrim.*

Për me tepër Kolegji i Këshillit ka analizuar edhe testin me shkrim të kandidatës fituese S.G, ku e njëjta ka dhënë 20 përgjigje të sakta duke arritur 40 pikë, kurse lidhur me esen është vlerësuar me 13 pikë, duke arritur gjithsej 53 pikë, pra, nuk qëndron pretendimi ankimor se i tërë rezultati është manipuluar për qëllime të kandidatës fituese, sepse, kjo e fundit ka dhënë më shumë përgjigje të sakta tek pyetjet më shumë opsione dhe së e njëjta ka marr vlerësim me të vogël të eseja se sa ankuesja, çka nënkupton së nuk ka diskriminim apo trajtim jo të barabartë të ankueses në raport me kandidaten fituese.

Gjegjësisht, në vështrim të parimit të meritokracisë, si një nga parimet bazë për pranim në shërbim, Kolegji ka shqyrtuar dosjen e aplikimit të kandidatës fituese S.G, si kandidate me më së shumti pikë, ku dhe vërtetohet se e njëjta lidhur me kriterin e arsimit ka ofruar si dëshmi: Diplomën me numër Nr.191/16 të datës 22.09.2016, për përfundimin e studimeve themelore (datë 01.07.2016), në Fakultetin Juridik, me specializim në Civil, Kolegji “Iliria”, Përkitazi me përvojën e punës pas diplomimit ka bashkangjitur Kontratën për Angazhim të Konsulentit në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe Iniciativa Kosovare për Stabilitet, me të cilën vërtetohet se kandidatja ka qenë e angazhuar në pozitën Konsulente nga data 01.03.2018 deri më datën 31.05.2018, në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale; Marrëveshjen për Angazhim në Masën Aktive të Tregut të Punës Praktike, me numër protokollit 005, të datës 05.07.2019, me të cilën vërtetohet se e njëjta ka qenë e angazhuar si praktikante në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale, nga data 05.02.2019 deri më datën 04.09.2019; Marrëveshjen për Angazhim në Masën Aktive të Tregut të Punës Praktike, me numër protokollit 138, të datës 05.01.2021, nga e cila nuk mund te vërtetohet periudha e angazhimit; Marrëveshjet për Shërbime në Likuidim më Agjencinë Kosovare e Privatizimit, me të cilën vërtetohet se ka qenë e angazhuar si Ofruese e Shërbimeve nga data 01.03.2023 deri 31.08.2023; 01.09.2023 deri më datë 31.12.2023; 01.01.2024 deri më 30.06.2024, dhe 01.07.2024 deri më datë 31.12.2024. Pra, mbi bazën e këtyre dëshmive rezulton se kandidatja S.G ka plotësuar kriteret e përgjithshme formale të përcaktuar me konkurs, e duke qenë së e njëjta në fazën e vlerësimit ka arritur gjithsej 80.6 pikë të përgjithshme, duke u renditur si kandidatja me më së shumti pikë të mbledhura, atëherë, e njëjta konsiderohet edhe si kandidate e suksesshëm për këtë procedurë të pranimit, kështu që, edhe njësia përgjegjëse në këtë rast Njësia e Burimeve Njerëzore në Institutin e Krimeve të Kryera Gjatë Luftës në Kosovë ka vepruar në pajtim me nenin 11 të Rregullores Nr.15/2023 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Bazuar në konstatimet si me lartë, dhe duke qenë së nuk janë evidentuar shkelje ligjore në procedurën e kontestuar, atëherë, Kolegji i Këshillit erdhi në përfundimin së procedura me nr.ref: RN00016671, është zhvilluar në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë, si dhe Rregulloren Nr.15/2023 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, kështu që, në kuptim të dispozitave të nenit 18, paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe nenit 132, paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda: A.nr. 768/2025

Kaltrina Avdullahi-Prenaj

Procesmbajtëse

Ardita Haxhnikaj Demi

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankueses, M.D-K;
- Njësisë së Burimeve Njerëzore në Institutin e Krimeve të Kryera Gjatë Luftës në Kosovë; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.